



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:043833

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05522309

Ac.nr.7322/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca – Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.Xh, nga Gj....., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit K.A-S, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor B.M nga Gjilani, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.742/20, të datës 23.06.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesat e paditësit N.Xh, nga Gj..... dhe e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.742/20, të datës 23.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.742/20, të datës 23.06.2021, ka vendosur si në vijim: *“I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Xh nga Gjilani, dhe obligohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale për Arsim në Gjilan, që paditësit t`ia paguajë: në emër të shpenzimeve për ushqim për periudhën prej 18.04.2017 deri më 17.04.2021, pra për 649 ditë pune, nga 2 € në ditë, shumën prej 1.298,00 €, me kamatë ligjore prej 8%, sipas LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën që nga dita e ushtrimit të padisë, pra që nga*

data 15.03.2020 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditës, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërkaq për shumën e kërkuar përtej asaj të gjykuar, përkatësisht shumën prej 315,75 €, e cila paraqet 75% të pagës bazë të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar, për 20 vjet përvojë pune, me kamatë ligjore në këtë shumë prej 8%, duke e llogaritur të njëjtën që nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, kërkesëpadia e paditësit refuzohet si e pabazuar. II. Obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00 €, në afat prej 7 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditësi, përmes të autorizuarës së tij, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, e bazuar ose të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të kthehet rasti në rigjykim dhe rivendosje, si dhe i kërkon shpenzimet për ankesë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit në pikën I të dispozitivit për shpenzimet e ushqimit dhe në pikën II për shpenzimet e procedurës, si e pa bazuar në ligj ose të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të kthehet rasti në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi, përmes të autorizuarës së tij, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës, me propozim që e njëjta të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, si dhe i kërkon shpenzimet për ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, me dt. 15.03.2020, ka ushtruar padi, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria e Arsimit në Gjilan, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë për 649 ditë pune nga 2 € në ditë dhe për shpërblimit jubilar për 20 vite përvojë pune, 75% të pagës bazë, në shumën e përgjithshme prej 1.613,75 € me kamatë ligjore 8% sipas LMD-së, si dhe shpenzimet e procedurës, e si në precizimin me parashtrësën e dt. 27.10.2020 në seancën e dt. 23.06.2021.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses dhe precizimit të saj, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.742/20, të datës 23.06.2021, me të cilin e ka aprovuar

pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se i njëjti punon si mësimdhënës i lëndës së fizikës në SH.F.M.U “.....” dhe “.....” në Gjilan dhe në bazë të Vërtetimit të SH.F.M.U “.....”, nr., të dt. 19.12.2019, paditësi në ditën e lëshimit të vërtetimit ka pasur 24 vite të përvojës së punës edhe atë nga 01.09.1992 deri me 31.08.2003 dhe prej 01.09.2006 deri me 31.08.2008, si mësimdhënës i lëndës matematikë-fizikë në SHFMU “.....” në P..... dhe që nga data 01.09.2007 e këtej në SHFMU “.....” në Gj..... Në bazë të listës së pagave për muajin nëntor 2019, paditësi i ka pasur 24 vjet përvojë pune, ndërkaq për muajin e lartpërmendur paga e tij bazë ka qenë 421 €, e jo bruto 527.96 € ndërsa neto 463.60 €, andaj në bazë të vërtetimit të lartcekur nga i cili ka rezultuar se paditësi ka 24 vite të përvojës së punës, rezulton se vitin jubilar e ka arritur në vitin 2015, ndërsa padinë e ka ushtruar me dt. 18.03.2020, pas 5 viteve pasi që janë plotësuar kushtet për shpërblim jubilar andaj konform nenit 87 të Ligjit të Punës, gjykata ia refuzoi pjesërisht kërkesëpadinë për shpërblim jubilar, për shkak se kërkesa e tillë është parashkruar.

Sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë sipas vërtetimeve të shkollave SH.F.M.U “.....” dhe “.....” në Gj....., është vërtetuar se paditësi për periudhën 18.04.2017 deri me dt. 17.04.2021, ka gjithsej 649 ditë pune, ndërsa e paditura nuk e ka rregulluar ushqimin e punëtorëve në shkollë, përmes kuzhinës apo restorantit, andaj edhe është e obliguar t'ia paguajë shpenzimet e ushqimit për 649 ditë pune nga 2 € në ditë, shumën e përgjithshme prej 1.298,00 €.

Gjykata duke u bazuar në nenin 35 par 7 dhe 8 pika 8.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj edhe vendosi sikur në dispozitiv të aktgjykimit. Pretendimet e të paditurit se paditëses i mungon baza ligjore, i refuzoi si të pa bazuara duke u bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës dhe nenit 245 të LMD –së, ndërsa pretendimet rreth parashkrimit të kërkesës për shpërblim jubilar e ka aprovuar duke e refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit në këtë pjesë, duke iu referuar nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që padinë paditësi e ka ushtruar me datë 18.03.2020 pas 5 viteve që e ka arritur të drejtën për të kërkuar shpërblimin jubilar. Për kamatën për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë për kompensimin e shujtave, vendosi duke u mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e administruara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Është i pabazuar pretendimi ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se gjykata e shkallës së parë mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara drejtë ka vërtetuar se paditësit i takon e drejta në kompensimin e ushqimit duke theksuar se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se i njëjti punon si mësimdhënës i lëndës së fizikës në SH.F.M.U “.....” dhe “.....” në Gj..... dhe sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë sipas vërtetimeve të shkollave SH.F.M.U “.....” dhe “.....” në Gj....., është vërtetuar se paditësi për periudhën 18.04.2017 deri me dt. 17.04.2021, ka gjithsej 649 ditë pune, ndërsa e paditura nuk e ka rregulluar ushqimin e punëtorëve në shkollë, përmes kuzhinës apo restorantit, andaj edhe është e obliguar t`ia paguajë shpenzimet e ushqimit për 649 ditë pune nga 2 € në ditë, shumën e përgjithshme prej 1.298,00 €.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *”Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Me nenin 35 paragraf 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*.

Me nenin 46 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për të informuar dhe ndihmuar komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 “*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për periudhën nga dt. 18.04.2017 deri me dt. 17.04.2021, për gjithsej 649 ditë pune, shumën prej 1298 €, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Në raport me pretendimin ankimor të të paditurës se e njëjta nuk ka mundur të planifikojë në skemën e saj buxhetore, linjë të veçantë për këtë lloj kompensimi, është i pabazuar, ngase një pretendim i tillë nuk e argumenton mos pagesën e pagave jubilarë dhe shujtës ditore, një e drejtë që i takon paditëses.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me shpërblimin jubilar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, për arsye se, në bazë të Vërtetimit të SH.F.M.U “.....”, nr....., të dt. 19.12.2019, paditësi në ditën e lëshimit të vërtetimit ka pasur 24 vite të përvojës së punës edhe atë nga 01.09.1992 deri me 31.08.2003 dhe prej 01.09.2006 deri me 31.08.2008, si mësimdhënës i lëndës matematikë-fizikë në SHFMU “.....” në P..... dhe që nga data 01.09.2007 e këtej në SHFMU “.....” në Gj....., ndërsa në bazë të listës së pagave për muajin nëntor 2019, paditësi i ka pasur 24 vjet përvojë pune, ndërkaq për muajin e lartpërmendur paga e tij bazë ka qenë 421 €, e jo bruto 527.96 € ndërsa neto 463.60 €, pra vitin jubilar paditësi e ka arritur në vitin 2015, ndërsa padinë e ka ushtruar me dt. 18.03.2020, pas 5 viteve pasi që janë plotësuar kushtet për shpërblim jubilar, andaj konform nenit 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit parashihet se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, e që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejta ia ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë, për shpërblim jubilar, për shkak se kërkesa e tillë është parashkruar.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 i LMD-së,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7322/21, me datë 28.03.2024

Kryetare e kolegjit
Nora Bllaca – Dula, d.v.